

**BULETINI MUJOR I  
SËMUNDSHMËRISË  
INFEKTIVE****(Pasqyra 14/Sh)****DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË  
SËMUNDJEVE INFEKTIVE****SHTATOR 2021**

Buletini MuJOR i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin MuJOR bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS) të raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh. Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh për muajin shtator 2021 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH) në të gjitha bashkitë e vendit.

### **1. Sëmundjet diarreike**

Sëmundjet diarreike gjatë muajit shtator 2021 zënë 50.49 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 326.3/100.000 banorë. Gastroenteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 3.14/100.000 banorë. Rrethet Berat dhe Bulqizë mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastroenterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa rretheve të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën laboratorike mikrobiologjike.

Gjatë muajit shtator 2021 janë raportuar 4 raste (Incidenca 0.14/100.000 banorë) të konfirmuara me Salmonelozë jotifoide. NJVKSH Shkodër ka raportuar 3 raste të konfirmuara (Incidenca 0.1/100.000 banorë), dhe një rast i konfirmuar në Tiranë. Bashkia Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Shigelozës për muajin shtator 2021 në nivel kombëtar 9 raste të konfirmuara (Incidenca 6.63/100.000 banorë).

**Tabela 1: Frekuenat dhe incidenat e sëmundjeve diarreike për muajin Shtator 2021  
(Incidenca raste/100.000 banorë)**

	Raste shtator 2021	Incidenca gusht 2021 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0
Salmonelozë	4	0.14
Shigelozë (Disenteri bacilare)	9	0.31
Dizenteri amebike	0	0
Toksiko-infeksione alimentare	90	3.14
Gastroenterite (etiologji e panjohur)	9238	322.73
Sëmundje diarreike në total	9341	326.3

## 2. Sëmundjet e EPI

### 2.1 Tuberkulozi pulmonar

Gjatë muajit shtator 2021 janë raportuar 15 raste (Incidenca 0.52/100.000 banorë) me tuberkuloz pulmonar. Nga ekzaminimet laboratorike 13 raste janë konfirmuar sputum pozitiv. Konfirmimi i tyre është kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Rastet janë të shpërndara në të gjithë vendin përkatësisht nga 1 rast në Elbasan, Dibër, Fier, Lezhë, Lushnjë dhe Pogradec, si dhe nga tre raste në Durrës, Kurbin dhe në Tiranë.

## 4. Hepatitet virale

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit shtator 2021 janë raportuar në total 23 raste me hepatit viral B të konfirmuar (Incidenca 0.8 /100.000 banorë), 22 raste të raportuara nga NJVKSH Tiranë dhe një rast nga NJVKSH Durrës. Në muajin shtator 2021 janë raportuar 10 raste me Hepatit Viral as A as B, të raportuara nga NJVKSH Tiranë 9 raste dhe 1 rast nga NJVKSH Durrës.

## 5. HIV/AIDS

Në muajin shtator 2021 janë kryer në total 33 ekzaminime për HIV në Njësinë e Laboratorëve në Institutin e Shëndetit Publik (ISHP). Nga këto ekzaminime 8 prej tyre kanë rezultuar pozitive (5 meshkuj dhe 3 femra). Rastet pozitive i përkasin moshave të ndryshme nga 26 deri 62 vjeç. Rastet pozitive janë nga rrethet Tiranë, Durrës dhe Kukës. Mostrat e gjakut që kanë rezultuar pozitive kanë ardhur në ISHP nga QSUT (Spitali Infektiv), QKTGJ, vullnetarë, laborator privat (GENIUS) dhe shoqata të ndryshme.

INSTITUTI I

SHËNDETIT PUBLIK

DEKSI